



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Tipologji tekstore e gjuhës B (2)
(Tipologji informuese dhe gazetareske)

Ngarkesa: Numri i krediteve: 4 (katër); 40 orë mësimore (seminare)
Viti / Semestri ; Viti II , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Studenti njeh teknikat bazë për të analizuar tekstet informative dhe gazetareske. Studenti përdor me shkathësi të gjithë elementët gjuhësorë të cilët përdoren më shpesh dhe të cilët i lejojnë jo vetëm të kuptojë tekstin informativ por dhe ta përcjellë atë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studenti detekton elementët lidhës, kohezionues të një teksti informues e gazetaresk.
2. Studenti realizon komentarin gjuhësor të teksteve informues e gazetareskë.
3. Studenti komenton një tekst informativ e gazetaresk duke u nisur nga një model dhe e imiton atë.
4. Studenti përpunon informacionin e artikujve informues mbi tema të caktuara.
5. Ai ndërton skemën e textit informues që i jepet apo ndërton skemën e esesë informuese të cilën ai do të shkruajë mbi një model, a temë të caktuar.